



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1320, datë 28.06.2010

Per

“Fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis Mobile 4 AL, Albtelecom sh.a, AMC sh.a, Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.06.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Zgjidhje mosmarreveshje Interkoneksioni midis Mobile 4 AL, Albtelecom sh.a, AMC sh.a, Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”.

BAZA LIGJORE

1. Neni 120, i Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
2. Nenet 66-104 te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A).
3. Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010.
4. Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300 , date 14.06.2010.
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Mobile 4 AL, me shkresen nr. 2444 prot, date 14.06.2010 i është drejtuar AKEP me kërkesen për zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni me operatorët Albtelecom, AMC, Eagle Mobile dhe Vodafone Albania , pasi palet nuk kanë rënë dakort për lidhjen e marreveshjeve perkatëse të interkoneksionit.
2. Mobile 4 AL në shkresën e referuar ka dhënë informacion në lidhje me korespondencën shkresore dhe komunikimeve të realizuara midis Operatoreve me Fuqi të Ndjeshme në Treg si më poshtë vijon:
 - a) Sipermarresi Mobile 4 Al i është drejtuar Albtelecom nepermjet:
 - Shkreses nr. 79 prot, date 18.03.2010.
 - Vijuar me shkresën nr. 114 prot, date 09.04.2010 me objekt moskthim përgjigje të shkresës nr. 79 prot, date 18.03.2010;
 - Shkreses nr. 158 prot, date 28.04.2010 mbi shkëmbim korespondence për informacionin teknik dhe dokumentacionin ligjor dhe pasuar me takimin e mbajtur më 15.04.2010 në zyrat e Albtelecom;
 - Shkreses nr. 194 prot, date 12.05.2010 “Për propozim të cmimeve”;
 - Shkresën nr.200 prot, date 13.05.2010 me objekt “ Konfirmim mbi shërbimet dhe kapacitetet e propozuara nga Mobile 4 AL;
 - Shkresën nr. 239 prot, date 24.05.2010 me objekt “Moskthim përgjigje të shkresës nr. 194 prot, date 12.05.2010”;
 - Vijuar me pas me takimin në zyrat e Albtelecom me datë 01.06.2010.
 - b) Sipermarresi Mobile 4 Al i është drejtuar Albanian Mobile Communications (AMC) nepermjet:
 - Shkreses nr 80 prot, date 18.03.2010 vijuar me takimin e mbajtur pranë më 13.04.2010 në zyrat e Mobile AL, si dhe vazhdimin e komunikimeve me email dhe shkëmbimin e marreveshjes së interkoneksionit;
 - Shkreses me nr. 197 prot, date 12.05.2010 “Për propozimin e tarifës së terminimit”, vijuar me shkresën nr. 238 prot, date 24.05.2010 “Mos marrje përgjigje për mbi propozimin e tarifës së terminimit”, e pasur kjo me pas me shkresën nr.243 prot, date 25.05.2010 “ Kopje e shkresës së dërguar me nr. 197 prot, date 12.05.2010;
 - Nderkohe AMC i përgjigjet Mobile 4 AL me shkresën nr. 245 prot, date 26.05.2010.
 - c) Komunikimi i Mobile 4 Al me Eagle Mobile nepermjet:
 - Shkreses nr. 81 prot, date 18.03.2010;
 - Shkreses nr. 113 prot, date 09.04.2010 “ Moskthim përgjigje e shkresës nr 81 prot, date 18.03.2010;
 - vijuar me takimin e mbajtur më 21.04.2010 në zyrat e Eagle Mobile:

- Shkreses nr. 155 prot, date 27.04.2010 per shkembimin e informacionit teknik dhe dokumentacionin ligjor;
 - Shkembimit te informacionit te Marreveshjes se Interkoneksionit dhe shkreses nr. 196 prot, date 12.05.2010 “Per propozim te cmimeve”
 - Shkreses nr.240 prot, date 24.05.2010 “Per te konfirmuar takimin” i cili u mbajt ne zyrat e Eagle Mobile me date 31.05.2010.
- d) Komunikimi i Mobile 4 Al me Vodafone Albania nepermjet:
- Shkreses nr. 84 prot, date 23.03.2010, vijuar me shkembim korrespondence per informacionin teknik dhe dokumentacionin ligjor;
 - Shkreses nr. 127 prot, date 16.04.2010, vijur me takimin e mbajtur me date 05.05.2010 prane zyrave te Vodafone Albania;
 - Shkembimit te informacionit te Marreveshjes se Interkoneksionit dhe shkreses nr. 195 prot, date 12.05.2010 “Per propozim te cmimeve”
 - Takimit te realizuar ne zyrat e Vodafone Albania me date 31.05.2010.
2. Mobile 4 AL thekson se pavaresisht te gjitha perpjekjeve dhe negociatave me operatoret me FNT dhe pasi kane rene dakort per nje pjese te konsiderueshme te kushteve te Marreveshjes se Interkoneksionit, nuk ka arritur ne nje marreveshje me asnjerin prej operatoreve ne lidhje me tarifen e interkoneksionit per terminimin e thirrjeve te gjeneruara nga rrjetet e ketyre operatoreve ne rrjetin e Mobile 4 AL;
 3. Komunikimet e mesiperme dhe shkresat e derguara ne AKEP, nga 5 operatoret, vertetojne se Mobile 4 Al ka bere kerkese per lidhje marrveshje interkoneksioni tek te kater operatoret e cituar, por negociatat mes paleve nuk kane rezultuar ne lidhjen e marrveshjes se interkoneksionit bernda 45 diteve nga data e kerkeses. Objekt i mosmarrveshjes eshte tarifa e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Mobile 4 Al, pasi operatori Mobile 4Al kerkon nivel asimetrie me operatoret aktuale me te larte se ajo qe pranojne operatoret e tjere. Mobile 4 Al ka vene ne dijeni AKEP per tarifen e propozuar te asimetrise, por AKEP ne vijim te Analizes se tregut celular te publikuar me 31.03.2010, nuk eshte prononcuar pasi palet kane te drejten dhe detyrimin qe fillimisht te kryejne negociata me njeri tjetrin, dhe me pas te investojne AKEP per zgjidhje mosmarrveshjes.
 4. Mobile 4Al, ne mbeshtetje te pretendimit per nivelin e tarifes se propozuar per terminimin e thirrjeve ne rrjetin e vet, ka perfshire argumenta dhe referenca te tregut ne Shqiperi dhe rekomandime te Komisionit Europian, per asimetrine.
 5. Bazuar ne nenin 50 te Ligjit 9918, Mobile 4Al ka te drejte te paraqese ankesen ne AKEP per zgjidhje te mosmarreveshjes ne rastet e moslidhjes se marreveshjes brenda 45 diteve nga data e kerkeses per interkoneksion.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zgjidhjes së mosmarreveshjes së interkoneksionit midis operatoreve Mobile 4 AL, Albtelecom, AMC, Eagle Mobile dhe Vodafone Albania, për tregun dhe konsumatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 7 i Rregullores “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarreveshjeve” si dhe pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP, e ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarreveshjes së interkoneksionit midis operatoreve Mobile 4AL sh.a, Albtelecom sh.a, AMC sh.a, Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.
2. Palet deri me datë 6.07.2010, të depozitohen në AKEP pretendimet me shkrim.
3. Për ndjekjen e këtij procedimi administrativ, ngarkohet Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe Drejtoria Juridike.
4. Të njoftohen palët e interesuara për këtë vendim.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**